



Parku Industrial i Kompletuar i Koplikut (Shqiperi)

Qeveria Shqiptare ka percaktuar ne Qarkun e Shkodres, Bashkia Koplik, nje zone qe shtrihet ne afro 64 hektare per realizimin e nje parku industrial, ne te cilin jane parashikuar tipologji te ndryshme te aktiviteve prodhuese, pervec sherbimeve, aktiviteve tregtare dhe logjistike.

Kjo zone shtrihet pergjate rruges qe lidh Shkodren me Pogoricen, dhe ndodhet vetem afro 12 km larg kufirit me Malin e Zi.

Realizimi i Parkut i eshte besuar nga Qeveria Shqiptare, ne formen e koncesionit, shoqerise Zona Industriale dhe Tregtare Koplik Sh.p.k. (ZITK), ne te cilen bejne pjese sipermarres italiane qe veprojne ne Shqiperi, ASI Bari, dhe nje sipermarres shqiptar.

Investimi dhe realizimi i parkut ndiqet me nje vemendje te vecante nga Autoritetet Shqiptare dhe nga Ambasada Italiane ne Tirane, pasi behet fjale per nje projekt pilot per krijimin ne Shqiperi te zonave ku do te prodhohet dhe qe mbi te gjitha synon ne zhvillimin ekonomik te zones veriore.

Projekti parashikon rrethimin e te gjithe zones se interesuar nga nderhyrja qe do kryhet dhe nje hyrje te kontrolluar.

Siperfaqet ne dispozicion per vendosjen e aktiviteve prodhuese jane te ndara ne zona:

- qendra tregtare ekspozuese 48.452 m²
- qendra shume funksionale me nje siperfaqe prej 24.726 m² e destinuar per sherbime te vecanta si shkolla formimi, ambulator, dogana, asistence te pergjithshme dhe shqerbime kolektive si hotele dhe akomodim, banka, shoqeri sigurimi dhe zyra te ndryshme.
- zona e destinuar si platforme logjistike me nje siperfaqe prej 68.727 m²
- zona per aktivitetet prodhuese 279.454 m²
- zona e destinuar per sherbimet teknologjike me nje siperfaqe prej 28.041 m²
- zona e destinuar per rrjetin rrugor, parkime dhe zone e gjelber me nje siperfaqe te pergjithshme prej 195.202 m².

Projekti parashikon gjithashtu ndertimin e gjithe infrastruktures se zones qe do te kete nje ujesjelles autonom per perdorim civil dhe industrial, rrjetin e kanalazimeve te ujrave te zeza dhe te bardha, rrjetin shperndares te gazit, rrjetin shperndares te energjise elektrike, rrjetin teletex, rrjetin publik ndricues dhe kunder zjarrit.

Fillimi i punimeve per infrastrukturen dhe rrjetin rrugor te zones eshte parashikuar te jete brenda shkurtit 2009.

Siperfaqet e para te kompletuara per vendosjen e aktiviteve prodhuese do te jene gati qysh pas 15 ditesh nga fillimi i punimeve, nderkohe qe e gjithe nderhyrja do te perfundoje brenda 30 muajsh nga fillimi i punimeve.

Zonat ne brendesi te parkut te destinuara per aktivite prodhuese dhe sherbimi do jene objekt i dhenies ne pronesi, perkundrejt pageses te nje shume te percaktuar ne baze te kostove te blerjes dhe infrastrukturimit te gjithe zones, investitoreve italiane dhe te huaj te interesuar per t'u vendosur ne Shqiperi por edhe investitoreve dhe operatoreve shqiptare.

Shoqeria koncesionare, sipas kerkesave, ofron, pervec mundesise per te blere ndarje (loti) brenda parkut, edhe realizimin e ndertesave dhe kapanoneve industriale "celes ne dore" (chiavi in mano), pasi ka ne perberje te saj shoqeri qe veprojne ne Shqiperi dhe qe jane te specializuara per keto lloje veprash.

Ndarjet (loti) fillojne nga nje siperfaqe minimale prej 2.000 m².

Te investosh ne Shqiperi, edhe sot, paraqet nje mundesi per t'u shfrytezuar nga ata e atyre qe kryejne aktivitetete te ndryshme.

Vendi zhvillohet cdo dite e me shume dhe forcohet nga ana institucionale per te arritur ne nje te ardhme te afert objektivat e vena ne Marreveshjen e Stabilizim-Asocimit te nenshkruar me Komunitetin Evropian dhe per tu bere anetare te ketij te fundit.

Investitoret e huaj mund te perfitojne te drejten e plote te pronesise edhe asaj intelektuale.

Procedurat burokratike jane thjeshtuar shume nepermjet krijimit te nje Sporteli te Vetem qe lejon regjistrimin e shoqerive ne nje dite te vetme.

Tatimi mbi te ardhurat eshte unik dhe eshte ne masen 10% mbi te ardhurat.

Procedurat doganore po shkojne gjithmone e me shume drejt thjeshtimit kjo edhe per rrjedhoje te marreveshjes te shkembimit te lire qe eshte ne fuqi ne zonen jugore te Ballkanit por edhe fale marreveshjeve me vende te ndryshme te Evropes.

Sistemi financiar dhe sigurues eshte shume i zhvilluar dhe vihet re prezenca e bankave te rendesishme te huaja si Intesa SanPaolo Bank, Raiffeisen Bank etj.

Qarku i Shkodres ofron nje treg pune shume interesant dhe qe eshte i perbere nga burime njerezore te kualifikuara.

Qarku ka nje popullsi prej 325.416 banore.

Ne qytetin e Shkodres ne vecaneti ndodhet Universiteti prane se cilit aktualisht jane regjistruar 6.000 studente dhe cdo vit diplomohen 500 nxenes.

Kostoja e burimeve njerezore eshte mjaft e ulet, ne vecaneti nje person i kualifikuar merr nje rroge mujore prej afro 250,00 euro dhe kontributet shoqerore dhe shendetsore jane te barabarta me 20%.

Lidhjet dhe transporti nga dhe drejt Shqiperise jane te garantuara nga Aeroporti i Tiranes dhe nga Aeroporti i Podgorices, nga Porti i Durrresit, nga Porti i Shengjinit dhe nga porti i Bar-it ne Malin e Zi, nga linja hekurudhore Mali i Zi-Greqi dhe nga rruga qe lidh Durresin me Malin e Zi.

Investitoret e interesuar per t'u vendosur ne Parkun Industrial te Koplik-ut mund te shprehin interesin e tyre duke perdorur formularin e posacem Manifestim Interessi.